



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË FUSHË KOSOVËS PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Fushë Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Fushë Kosovës (FK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Fushë Kosovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Mangësitë e evidentuara në menaxhimin dhe regjistrimin e pasurive kanë rezultuar në pasaktësi materiale në prezantimin e pasurive në Pasqyrat Financiare Vjetore, duke shkaktuar mbivlerësim të pasurive në vlerë totale prej 5,819,755€, si dhe nënvlerësim në vlerë prej 206,707€;
- B1 Shpenzime në vlerë prej 2,072,136€ ishin realizuar dhe prezantuar në kategori ekonomike jo adekuate;
- C1 Mos shpalosja e plotë dhe e saktë e detyrimeve kontigjente në PFV, ka rezultuar në nënvlerësim të tyre në vlerë prej 71,513€;
- A2 Nënvlerësim i llogarive të arkëtueshme në vlerë prej 27,256€ si rezultat i moszbatimit të plotë të kushteve kontraktuale.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Fushë Kosovës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A3 Në një rast, kishte mospërputhje mes stafit të deklaruar në ofertë dhe stafit të angazhuar gjatë zbatimit të kontratës së shërbimeve;
- A4 Komuna kishte angazhuar 11 punëtorë për periudhë trevjeçare në kuadër të projektit “Forcimi i kapaciteteve të Administratës Komunale” si dhe tre (3) ekspertë me marrëveshje për shërbime të veçanta për kryerjen e detyrave të rregullta në kundërshtim me kërkesat ligjore;
- A5 Në (6) raste, komuna kishte lidhur kontrata të qiradhënies për prona që nuk ishin në pronësi të komunës;
- A6 Në dy raste të subvencionimit Start-Up në vlerë 3,500€, mungonin marrëveshjet me përfituesit e subvencioneve;
- B2 Komuna nuk kishte arritur të realizojë inspektimin e së paku 20% të pronave të paluajtshme, siç kërkohet me legjislacionin në fuqi.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i Komunës së Fushë Kosovës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunës së Fushë Kosovës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunës së Fushë Kosovës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Fushë Kosovës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Fushë Kosovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Fushë Kosovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Fushë Kosovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Fushë Kosovës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Kontrollet e brendshme, sa i përket raportimit financiar, duhet të përmirësohen dhe zbatohen tek evidentimi dhe menaxhimi i pasurive jo financiare, klasifikimi i shpenzimeve në kategoritë përkatëse, evidentimi dhe menaxhimi i llogarive të arkëtueshme dhe detyrimeve kontigjente. Ndërsa, sa i përket çështjeve të pajtueshmërisë, duhet të përmirësohet menaxhimi i tatimit në pronë dhe inspektimi i pronave, proceset e subvencionimit, menaxhimi i kontratave të qiradhënies së pronave komunale, si dhe menaxhimi i kontratave të shërbimeve dhe angazhimi i stafit/ekspertëve përmes projekteve si dhe për shërbime të veçanta. Gjithashtu, duhet të ndërmerren veprime në funksionalizimin e NjAB-së dhe Komitetit të Auditimit. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 13 rekomandime, prej tyre shtatë (7) janë rekomandime të reja, pesë (5) të përsëritura si dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Mangësi në evidentimin, regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive jofinanciare.

Gjetja Sipas nenit 6.1 të Rregullores Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive jo Financiare “Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj”. Ndërsa, neni 7.2 përcakton “Regjistrimi i transakcioneve në regjistrat përkatës duhet të bazohet në dokumentet burimore origjinale që dëshmojnë se transakcioni ka ndodhur në përputhje me autorizimet përkatëse. Po ashtu, neni 11 paragrafi 1 dhe 3 i kësaj rregulloreje përcakton se “Pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim”, “Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimin të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi”. Tutje, neni 6.5 përcakton se “Në raste kur mungojnë informatat financiare nga dhurimi i pasurisë jo financiare, organizata buxhetore do t'i regjistrojë pasuritë në regjistrat e pasurisë në bazë të vlerësimit të bërë nga Komisioni për vlerësim e Pasurisë jo Financiare. Ky vlerësim duhet të dokumentohet me dëshmi përkatëse”.

Gjatë auditimit të menaxhimit të pasurive kemi identifikuar mangësi dhe pasaktësi në regjistrimin dhe evidentimin e pasurive⁵, si në vijim:

- Në 18 raste, në vlerë prej 3,763,912€, pronat/tokat ishin regjistruar në

mënyrë jo të saktë në regjistrin e pasurive, përkatësisht, prona me numër të njëjtë kadastral ishin regjistruar dy herë, duke shkaktuar mbivlerësim të pasurive për këtë vlerë;

- Në gjashtë (6) raste, në regjistrin e pasurive ishin evidencuar prona/toka për të cilat Komuna nuk posedonte dokumentacion të plotë mbështetës, përfshirë certifikatat nga regjistri kadastral apo dëshmi tjera relevante mbi statusin e pronësisë dhe të drejtën e shfrytëzimit të tyre;
- Tre (3) pagesa të investimeve kapitale, në vlerë prej 206,707€, nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive si investime në vijim, duke shkaktuar nënvlerësim të pasurive për këtë vlerë;
- Pasuri në përdorim, në vlerë prej 1,175,736€, nuk ishin zhvlerësuar, duke ndikuar në mbivlerësim të pasurive për efektin e pazbatuar të zhvlerësimit në vlerë prej 50,491€;
- Në tre (3) raste kemi evidentuar gabime në regjistrimin e vlerës së pasurive, të cilat kanë shkaktuar mbivlerësim të pasurive për 2,005,352€; si dhe
- Objekti i komunës i pranuar si donacion, nuk ishte regjistruar në regjistrin e pasurive, i njëjti nuk ishte vlerësuar nga komisioni për vlerësimin e pasurive jo financiare.

Këto mangësi kanë ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve efektive në procesin e menaxhimit dhe regjistrimit të pasurive, si dhe neglizhencës së zyrtarit të pasurive në verifikimin, evidentimin dhe përditësimin e saktë të të dhënave në regjistrin e pasurive.

Ndikimi

Mangësitë e evidentuara kanë ndikuar që pasuritë të mos prezantohen në mënyrë të drejtë dhe të saktë në pasqyrat financiare, duke shkaktuar mbivlerësim/nënvlerësim të tyre, si dhe duke ulur besueshmërinë e informacionit financiar dhe të regjistrit të pasurive.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në procesin e menaxhimit dhe regjistrimit të pasurive, duke siguruar që regjistrimi i pasurive të bëhet në mënyrë të plotë, të saktë dhe në kohë, në përputhje me dokumentacionin mbështetës dhe kërkesat ligjore. Po ashtu, duhet të kryhen verifikime periodike për shmangien e regjistrimeve të dyfishta dhe gabimeve në vlera, si dhe të aplikohet zhvlerësimi në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Keq klasifikim i shpenzimeve në kategoritë ekonomike

Gjetja

Ligji Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2025, neni 15 parasheh që në rastin e komunës, ndarjet buxhetore nga “Rezerva” me prioritet ndahen në kategorinë përkatëse të shpenzimeve për shlyerjen e vendimeve përmbartimore dhe gjyqësore me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ. Këto mjete duhet të merren brenda kufijve buxhetor të përcaktuar me qarkore (pika 3, paragrafi i fundit), përjashtimisht mjetet nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Ndërsa, Rregulla Financiare Nr. 01/2013/MF - Shpenzimi i parasë publike, neni 18, përcakton që, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël.

Kemi identifikuar keq klasifikime në vlerë totale 2,072,136€. Detajet e rasteve të identifikuara janë si në vijim:

- Komuna nuk kishte planifikuar fonde rezervë për mbulimin e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore/përmbarrimore, në përputhje me kërkesat ligjore. Si pasojë, vendime gjyqësore në vlerë 1,921,761€, të cilat ndërlidheshin me obligime nga kontrata kolektive (paga jubilarë dhe shujta), ishin ekzekutuar nga Thesari nga kategoria e investimeve kapitale.
- Gjithashtu, nga mostrat e testuara janë identifikuar pagesa në vlerë 150,375€ të realizuara nga Komuna, të cilat nuk lidhen me vendime gjyqësore, por që po ashtu janë klasifikuar në kategori ekonomike jo adekuate. Konkretisht, katër (4) raste të pagesave në vlerë 134,673€ ishin ekzekutuar nga investimet kapitale, ndonësa sipas natyrës së tyre i takonin kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Po ashtu, pagesa në vlerë 15,702€, për 11 persona të angazhuar sipas Ligjit për Zyrtarët Publik, ishin realizuar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në vend të kategorisë së pagave dhe mëditjeve përmes listës së pagave.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së ndarjes së fondeve rezervë për mbulimin e detyrimeve nga vendimet gjyqësore/përmbarrimore si dhe dobësive në kontrollet e brendshme gjatë planifikimit buxhetor.

Ndikimi

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo adekuate, ndikon në mbivlerësimin ose nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve duke rezultuar në prezantim jo të saktë të shpenzimeve në raportin vjetor financiar.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë ndarjen e fondeve rezervë për mbulimin e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore/përmbarrimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe kufijtë buxhetorë të përcaktuar, si dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme që pagesa dhe regjistrimi i transaksioneve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Prezantimi jo i plotë dhe jo i saktë i detyrimeve kontigjente në PFV

Gjetja

Sipas nenit 6 të Rregullores MF. Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore parasheh se: “Organizatave buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurmuar dhe në harmoni e legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.

Në dy (2) raste⁶, në vlerë totale prej 71,513€, Komuna kishte nënvlerësuar detyrimet kontigjente në PFV, pasi nuk kishte shpalosur lëndë që ishin ende në proces gjyqësor dhe që mund të rezultonin me obligime financiare për Komunën në të ardhmen, ndonëse të njëjtat ishin prezantuar si detyrime kontigjente në PFV-të e vitit 2024.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mosraportimit dhe mosshpalosjes së saktë të rasteve gjyqësore nga Zyra Ligjore, si dhe mungesës së komunikimit me Zyrën e Financave gjatë përgatitjes së PFV-ve për vitin 2025.

Ndikimi

Mosshpalosja e rasteve gjyqësore si detyrime kontigjente ka ndikuar në nënvlerësimin e detyrimeve kontigjente në PFV dhe ka zvogëluar nivelin e transparencës dhe besueshmërisë së raportimit financiar.

Rekomandimi C1 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që Zyra Ligjore dhe Zyra e Financave të forcojnë komunikimin dhe koordinimin gjatë përgatitjes së PFV-ve, me qëllim të identifikimit dhe shpalosjes së plotë dhe të saktë të rasteve gjyqësore që mund të rezultojnë me detyrime kontigjente për Komunën.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Nënvlërësim i llogarive të arkëtueshme nga moszbatimi i plotë i kushteve kontraktuale

Gjetja Sipas nenit 6 të Rregullores MF Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, organizatat buxhetore duhet të mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë dhe të azhurnuar për të gjitha informatat financiare. Po ashtu, sipas Kontratës Publike Kornizë nr. 33, të datës 26.06.2020, operatori ekonomik obligohet të realizojë pagesat ndaj Komunës në baza mujore dhe në rast vonese aplikohet kamatë ditore prej 0.2% për çdo ditë vonesë.

Komuna kishte nënvlerësuar llogaritë e arkëtueshme për vitin 2025 në vlerë prej rreth 27,256€, pasi në pasqyrat financiare kishte raportuar vetëm 5,986€, ndërsa sipas dokumentacionit mbështetës dhe kushteve të Kontratës Publike Kornizë "Ofrimi i shërbimeve për bllokim dhe zhvendosje të automjeteve me marimangë", vlera e llogarive të arkëtueshme që duhej të raportohesh ishte rreth 33,242€.

Kjo pasi që operatori ekonomik kishte evidentuar vonesa në dorëzimin e raporteve mujore dhe regjistrave të automjeteve të tërhequra, ndërsa Komuna nuk kishte siguruar verifikim të rregullt të përmbushjes së kushteve kontraktuale dhe nuk kishte aplikuar kamatën ditore prej 0.2% për vonesat në përmbushjen e obligimeve financiare.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve efektive në verifikimin e raporteve mujore dhe përlllogaritjen e detyrimeve që rrjedhin nga kushtet kontraktuale nga menaxherja e kontratës.

Ndikimi Mosverifikimi i rregullt i obligimeve që rrjedhin nga kontrata dhe mosaplikimi i dispozitave kontraktuale ka ndikuar në nënvlerësimin e llogarive të arkëtueshme në PFV, duke paraqitur jo saktë gjendjen e të drejtave financiare të Komunës.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në menaxhimin e kontratës, përmes verifikimit të rregullt të raporteve mujore dhe përlllogaritjes së saktë të obligimeve që rrjedhin nga kushtet kontraktuale, me qëllim të evidentimit dhe raportimit të saktë të llogarive të arkëtueshme në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A3 - Mospërputhje në menaxhimin dhe verifikimin e stafit të angazhuar në kontratën e shërbimeve

Gjetja

Sipas Dosjes së Tenderit për “Ofrimin e shërbimeve shëndetësore, sociale, arsimore, ambientale dhe administratë e përgjithshme”, në kriterin “Kapaciteti teknik dhe profesional”, është përcaktuar që para nënshkrimit të kontratës operatori ekonomik i përzgjedhur duhet të dorëzojë listën e stafit të planifikuar për angazhim, të nënshkruar dhe të vulosur, ndërsa Autoriteti Kontraktues mban të drejtën e kontrollit dhe verifikimit të vazhdueshëm të angazhimit të tyre. Lista e dorëzuar nga operatori ekonomik përbëhet nga 136 persona të profileve të ndryshme.

Nga krahasimi i listës së stafit të dorëzuar nga operatori ekonomik para nënshkrimit të kontratës, e cila përmbante 136 punëtorë, me evidencat e përdorura gjatë zbatimit të kontratës, është konstatuar se stafi i angazhuar nuk përputhej me stafin e deklaruar. Konkretisht, për angazhimin dhe pagesën e punëtorëve ishte përdorur një listë tjetër operative, e hartuar dhe e ndryshuar gjatë zbatimit të kontratës nga menaxheri i kontratës, e cila përmbante 148 punëtorë.

Si rezultat, struktura dhe numri i stafit të angazhuar gjatë ekzekutimit të kontratës nuk reflektonte në mënyrë të plotë stafin e deklaruar dhe të vlerësuar gjatë procesit të tenderimit.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve dhe verifikimeve të mjaftueshme nga menaxheri i kontratës lidhur me përputhshmërinë e stafit të angazhuar me listën e stafit të deklaruar në ofertë dhe kontratë.

Ndikimi

Mospërputhshmëria ndërmjet stafit të deklaruar në ofertë dhe stafit të angazhuar gjatë zbatimit të kontratës ka dobësuar kontrollin mbi zbatimin e kontratës dhe ka rritur rrezikun që kontrata të mos zbatohet në përputhje me kushtet dhe kriteret mbi të cilat është bërë vlerësimi dhe dhënia e saj.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë që menaxheri i kontratës të kryejë verifikime të rregullta dhe të dokumentuara lidhur me përputhshmërinë e stafit të angazhuar me listën e stafit të deklaruar në ofertë dhe kontratë, me qëllim të sigurimit të zbatimit të kontratës në përputhje me kushtet e përcaktuara kontraktuale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Angazhimi i stafit dhe ekspertëve për kryerjen e detyrave të rregullta në kundërshtim me kërkesat ligjore**Gjetja**

Sipas Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores (QRK) Nr. 03/2024, marrëdhënia e punës me kontratë për periudhë të caktuar mund të themelohet vetëm për realizimin e një projekti specifik dhe të përkohshëm.

Sipas Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 57.2 përcakton se këto dispozita aplikohen vetëm për prokurimin e shërbimeve të veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit sipas Ligji për Zyrtarët Publik, ndërsa neni 57.3 përcakton se shërbimet e veçanta janë shërbime profesionale për të cilat Autoriteti Kontraktues ka nevojë, por që nuk mund t'i realizojë me stafin ekzistues. Tutje, neni 57.7 përcakton se kontraktimi i kontraktorëve individual duhet të bëhet përmes procedurave të prokurimit duke përdorur kriterin "Tenderi ekonomikisht më i favorshëm", në varësi të vlerës së parashikuar të kontratës.

Gjatë auditimit është vërejtur se komuna kishte përdorur forma alternative të angazhimit për mbulimin e nevojave të rregullta operative dhe organizative, përmes projekteve dhe marrëveshjeve për shërbime të veçanta, të cilat nuk ishin në përputhje me natyrën dhe qëllimin e paraparë për këto forma të angazhimit. Konkretisht:

- Gjatë vitit 2025, komuna kishte angazhuar 11 punëtorë për periudhën tre (3) vjeçare në kuadër të projektit "Forcimi i kapaciteteve të Administratës Komunale". Nga shqyrtimi i dokumentacionit është vërejtur se pozitat e angazhuara, përfshirë zyrtarë administrativë, ligjorë, inspektorë dhe zyrtarë teknikë, kryenin detyra të rregullta organizative dhe funksionale të komunës, e jo aktivitete të ndërlidhura me një projekt specifik dhe të përkohshëm;
- Komuna kishte zhvilluar procedura për angazhimin e tre (3) ekspertëve me marrëveshje për shërbime të veçanta, të cilët kishin kryer detyra me natyrë të rregullt operative dhe jo shërbime specifike profesionale, siç kërkohet për këtë lloj angazhimi. Po ashtu, nga shqyrtimi i kontratave dhe raporteve të punës është vërejtur se detyrat dhe përgjegjësitë e tyre nuk ishin të specifikuara qartë. Për më tepër, në njoftimin për kontratë ishte përdorur kriteri "çmimi më i ulët", në kundërshtim me kërkesat e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i planifikimit jo adekuat të nevojave për staf dhe moszbatimit të duhur të kërkesave ligjore dhe rregullative për angazhimin e stafit dhe ekspertëve.

Ndikimi

Përdorimi i formave alternative të angazhimit për mbulimin e detyrave të rregullta operative dhe organizative, rrit rrezikun e anashkalimit të procedurave të rregullta të rekrutimit, përdorimit jo adekuat të marrëveshjeve për shërbime të veçanta. Po ashtu, aplikimi i kriterit "çmimi më i ulët" për angazhimin e ekspertëve profesionalë rrit rrezikun e përzgjedhjes së kandidatëve pa vlerësim adekuat të cilësisë dhe kompetencave profesionale.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të sigurojë që angazhimi i stafit përmes projekteve dhe marrëveshjeve për shërbime të veçanta të realizohet vetëm për nevoja specifike dhe të përkohshme, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në

fuqi. Po ashtu, duhet të sigurohet që gjatë angazhimit të ekspertëve profesionalë të aplikohen kritere të përshtatshme vlerësimi, në përputhje me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Lidhja e kontratave për pronë që nuk ishin në pronësi të komunës

Gjetja

Sipas Rregullores QRK Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, neni 4, paragrafi 1.1 përcakton se: “Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës bazohet në kriterin që pronë të jetë e regjistruar si pronë komunale në regjistrat kadastral të pronës”.

Më tej, Ligji Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, neni 35, përcakton se “Kur objekti i detyrimit është i pamundur, i palejueshëm, i pacaktuar ose i cili nuk mund të caktohet, kontrata është absolutisht e pavlefshme”.

Gjatë testimit të mostrave të kontratave për shfrytëzimin me qira të banesave sociale, kemi identifikuar se Komuna kishte evidentuar llogari të arkëtueshme në vlerë prej 175,675€, për pronë të cilat, sipas dokumentacionit kadastral të verifikuar, nuk ishin në pronësi të Komunës së Fushë Kosovës, pasi që të njëjtat ishin pronë e AKP-së dhe ishin privatizuar që nga viti 2006.

Megjithatë, në gjashtë (6) rastet e testuara, kemi vërejtur se Komuna ndër vite kishte lidhur kontrata për shfrytëzimin me qira të këtyre banesave dhe kishte vazhduar administrimin e tyre, përkundër përkundër faktit se ato nuk ishin të regjistruara si pronë komunale.

Si rezultat, Komuna kishte krijuar marrëdhënie kontraktuale dhe kishte evidentuar llogari të arkëtueshme për pronë për të cilat nuk kishte bazë të mjaftueshme juridike për dhënie në shfrytëzim.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve efektive në verifikimin e statusit juridik të pronave para lidhjes së kontratave, si dhe mungesës së koordinimit ndërmjet zyrave përgjegjëse për menaxhimin e pronës komunale.

Ndikimi

Lidhja e kontratave për pronë që nuk ishin në pronësi të Komunës paraqet mosrespektim të kërkesave ligjore dhe rrit rrezikun e administrimit jo të rregullt të pronës komunale, si dhe mund të ndikojë në realizueshmërinë e llogarive të arkëtueshme të evidentuara për këto pronë.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të sigurojë që, para lidhjes së kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronave, të verifikohet statusi juridik dhe pronësor i tyre, në mënyrë që administrimi dhe dhënia me qira të realizohen vetëm për pronë që janë në pronësi të Komunës dhe në përputhje me kërkesat ligjore. Po ashtu, duhet të shqyrtohet statusi i kontratave ekzistuese dhe llogarive të arkëtueshme që lidhen me këto pronë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Mungesa e marrëveshjeve për subvencionet Start-Up

Gjetja Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF - Shpenzimi i Parave Publike, neni 36 "Subvencionet dhe Transferet", pika 4, subvencionet që i paguhen një njësie të përcaktuar apo një ndërmarrjeje private duhet të bazohen në një marrëveshje zyrtare mbi formën e subvencionimit.

Gjatë testimit të dy (2) mostrave të subvencioneve për Start-Up në vlerë prej 3,500€, është vërejtur se me vendim të Kryetarit, përfituesve u ishin ndarë subvencione në mungesë të kontratave apo marrëveshjeve që do të përcaktonin kushtet dhe mënyrën e shfrytëzimit të fondeve të përfituara. Nga informacionet e siguruar gjatë auditimit është kuptuar se edhe përfituesit e tjerë të subvencioneve Start-Up nuk ishin pajisur me marrëveshje përkatëse.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve të brendshme dhe moszbatimit të plotë të kërkesave të përcaktuara në rregullat financiare lidhur me administrimin dhe monitorimin e subvencioneve dhe transfereve.

Ndikimi Mungesa e marrëveshjeve për subvencionim rrit rrezikun e mos përcaktimit të qartë të të drejtave dhe obligimeve të palëve, si dhe vështirëson monitorimin dhe sigurimin e përdorimit të fondeve sipas qëllimit të paraparë.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha subvencionet të mbështeten me marrëveshje zyrtare ku përcaktohen qartë kushtet e përfitimit, obligimet e përfituesve dhe mënyra e monitorimit të shfrytëzimit të fondeve, në përputhje me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B2 - Mosrealizimi i inspektimit të pronave të paluajtshme në përputhje me kërkesat ligjore.**

Gjetja Sipas nenit 15 të Ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, kërkohet që Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha pronave brenda territorit të Komunës.

Gjatë vitit 2025, Komuna nuk kishte realizuar asnjë inspektim (verifikim) të pronave të paluajtshme, duke mos përmbushur kështu kërkesën ligjore për inspektimin e së paku 20% të pronave të regjistruara brenda territorit të saj.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të dobëta dhe mungesës së stafit të mjaftueshëm për verifikimin dhe inspektimin e pronave në terren.

Ndikimi Mosrealizimi i inspektimit në nivelin e kërkuar ndikon në mos reflektimin e saktë të gjendjes reale të pronave në bazën e të dhënave, duke rezultuar në vlerësime jo të sakta të detyrimeve tatimore dhe potencialisht në arkëtim më të ulët të të hyrave vetanake nga tatimi në pronë.

Rekomandimi B2 Kryetari i Komunës duhet të ndërmarrë masa konkrete për fuqizimin e kapaciteteve njerëzore dhe rritjen e aktiviteteve të inspektimit të pronave,

në mënyrë që të sigurohet përmbushja e kërkesave ligjore dhe përditësimi i saktë i bazës së të dhënave për tatimin në pronë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga e mëditje ishte 9,242,746€, derisa gjatë vitit është shpenzuar pothuajse i tërë buxheti apo 9,242,047€, Numri i të punësuarve në fund të vitit ishte 1,065, ndersa numri i planifikuar sipas ligjit të buxhetit ishte 1,040. Ky tejkalim ishte rezultat i futjes së asambleistave të rinjë në sistemin e pagave.

Çështja B3 - Mos përfshirja e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore në procesin e rekrutimit të nëpunësve të shërbimit publik

Gjetja

Neni 80, pika 4, e Ligji nr. 08/L-197 për zyrtarët publik, përcakton që procedura e konkurrimit për nëpunësit e shërbimit publik organizohet nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (NjMBNj) e organit emëruar. Rregullorja (QRK) Nr.19/2024 për procedurat e përzgjedhjes së mësimdhënësve dhe personelit tjetër arsimor, neni 8, pika 8 dhe 9, përcakton që pranimi i dokumenteve bëhet nga NjMBNj e komunës, e cila bënë verifikimin paraprak të të gjitha aplikacioneve dhe përpilon listën e kandidatëve që kualifikohen për vazhdim të procedurave të përzgjedhjes. Ndërsa, neni 21 i kësaj rregullore, përcakton që procesi i përzgjedhjes së personelit arsimor koordinohet dhe drejtohet nga NjMBNj e punëdhënësit në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit, dhe se pjesë e komisionit të vlerësimit kërkohet të jetë edhe një anëtar i nominuar nga NjMBNj, e që është ekspert i burimeve njerëzore.

Në dy (2) raste të testuara të procedurave të rekrutimit të nëpunësve të shërbimit publik në sektorin e arsimit dhe të shëndetësisë, kemi vërejtur se, NjMBNj përveç publikimit të konkursit në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNj), nuk ishte përfshirë në procesin e rekrutimeve. Në komisionet e pranimit të kandidatëve nuk kishte marrë pjesë asnjë përfaqësues i NjMBNj-së. Të gjitha aktivitetet e rekrutimit, që nga aplikimi e deri te shpallja e rezultateve finale, ishin zhvilluar nga drejtoritë përkatëse, respektivisht Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Shëndetësisë. Sipas informatave të siguruara gjatë auditimit, kjo mënyrë e rekrutimit është aplikuar në të gjitha procedurat e zhvilluara gjatë vitit.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve efektive nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe menaxhmenti komunal për të siguruar përfshirjen e NjMBNj-së në të gjitha fazat e procedurave të rekrutimit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative në fuqi.

Ndikimi

Mos përfshirja e NjMBNj-së në procesin e rekrutimit rrit rrezikun që procedurat e rekrutimit të mos zhvillohen në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe standardet e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë që Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të koordinojë dhe të përfshihet në të gjitha fazat e procesit të rekrutimit të nëpunësve të shërbimit publik, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregulloret në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 65,589,472, pasurive jokapitale është 540,506, si dhe e stoqeve 210,318.

Çështja A7 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare

Gjetja

Neni 19 i Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare përcakton kërkesat për themelimin e komisionit për inventarizimin e pasurive jo financiare si dhe përgjegjësitë e tij. Ndërsa neni 21 i po kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare.

Komuna nuk kishte nxjerrë vendime për themelimin e komisioneve për inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive në njësitë organizative, me përjashtim të QKMF-së. Për pasojë, nuk ishte realizuar harmonizimi i gjendjes faktike të pasurive me regjistrat kontabël dhe regjistrin e pasurive.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve menaxheriale për iniciimin, themelimin dhe mbikëqyrjen e komisioneve të inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive në të gjitha njësitë organizative, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurat në fuqi.

Ndikimi

Mos realizimi i procesit të inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive, kufizon marrjen e sigurisë lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë, si dhe rrit rrezikun e paraqitjes jo të drejtë të pasurive në pasqyrat financiare.

Rekomandimi A7

Kryetari duhet të sigurojë nxjerrjen e vendimeve për inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive për të gjitha njësitë organizative, si dhe harmonizimin e gjendjes faktike të pasurive me regjistrat kontabël dhe regjistrin e pasurive, në përputhje me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme në fund të vitit 2025 ishin 7,590,793€, prej të cilave, tatimit në pronë i takojnë 7,213,659€, qirasë nga objektet e banimit dhe objektet publike 203,941€, lejeve ndërtimore 163,965€, shitjes së banesave 3,242€ si dhe 5,986€ nga largimi dhe deponimi i automjeteve.

Çështja B4 - Menaxhim joefektiv i llogarive të arkëtueshme dhe moszbatim i masave për inkasim

Gjetja

Sipas nenit 26 të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën prej dhjetë (10) eurove. Më tutje, neni 27 përcakton që, nëse tatimpaguesi nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën, nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, Komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Kontrata nr. 33, neni 3, pika 3.4 përcakton: “Pagesa ndaj Komunës do të bëhet në çdo muaj të përfunduar në raport me regjistrin e automjeteve të tërhequra, në llogari të Komunës, në intervalin jo më shumë se 15 ditë.” dhe pika 3.5: “Pas kësaj do të llogaritet kamata ditore prej 0.2% për çdo ditë të vonuar.” UA 06/2017, neni 16, pika 4: “Aplikuesi duhet të sjellë dëshminë e pagesës pas marrjes së konfirmimit, brenda 30 ditëve për kategorinë e II-të”.

Llogaritë e arkëtueshme në vitin 2025 kanë shënuar rritje prej 20% krahasuar me vitin paraprak, përkatësisht në vlerë prej 1,253,829€. Rritja më e theksuar është evidentuar te tatimi në pronë, me rritje prej 21%, kategori kjo që përfaqëson edhe pjesën më të madhe të totalit të llogarive të arkëtueshme.

Nga mostrat e testuara, në 54 raste të llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë në vlerë 178,180€, në pesë (5) raste të lejeve ndërtimore në vlerë 163,965€, në dy (2) raste të shfrytëzimit të hapësirës publike në vlerë 27,266€, në gjashtë (6) raste tek qiraja nga dhënia në shfrytëzim e pronës komunale në vlerë 32,459€, si dhe në një (1) rast të të arkëtueshmes për largimin dhe deponimin e automjeteve në vlerë 519€, Komuna nuk kishte ndërmarrë veprime ligjore përmes përmbaruesit për mbledhjen e këtij borxhi, edhe pse ishte tejkalluar afati i përcaktuar në kontratë dhe afati në shkresat për rikujtimin e borxhit.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve efektive në monitorimin dhe përcjelljen e llogarive të arkëtueshme, si dhe mosndërmarrjes me kohë të veprimeve ligjore për mbledhjen e borxheve.

Ndikimi

Mos arkëtimi në kohë i të hyrave dhe mungesa e veprimeve efektive për arkëtimin e tyre ndikon negativisht në buxhetin e komunës dhe kufizon mundësinë e financimit të projekteve dhe aktiviteteve nga të hyrat vetanake.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve efektive për monitorimin dhe menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, si dhe ndërmarrjen me kohë të

të gjitha masave ligjore ndaj debitorëve që nuk i përmbushin obligimet ndaj komunës, , në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

NjAB operon me dy anëtarë të stafit, drejtori i NJAB-së dhe një auditor. Gjatë vitit 2025 nuk kishte funksionuar kjo njësi për shkak të mosmarrëveshjeve me menaxhmentin e komunës dhe si rezultat nuk ishte kryer asnjë auditim. Për më shumë, gjatë këtij viti nuk ishte formuar as komiteti i auditimit.

Çështja B5 - Mos funksionimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe mos formimi i Komitetit të Auditimit

Gjetja

Ligji nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, neni 21 përcakton që njësia e auditimit të brendshëm ka pavarësinë funksionale në planifikimin e punës së auditimit, në kryerjen e auditimit dhe në raportim. Gjithashtu, neni 25 i këtij ligji, përcakton përgjegjësitë e drejtorit të NjAB-së për përgatitjen dhe dorëzimin e planeve strategjike dhe vjetore për miratim. Ndërsa, Rregullorja QRK Nr. 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në SSP obligon udhëheqësin e subjektit publik të sigurojë kushtet dhe resurset e nevojshme për funksionimin efektiv të auditimit të brendshëm. Po ashtu, Udhëzimi Administrativ MF-Nr.01/2019, neni 4, kërkon themelimin e Komitetit të Auditimit në subjektet që kanë të themeluar NjAB.

Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk kishte operuar gjatë vitit 2025 dhe nuk kishte kryer asnjë aktivitet auditimi, ndonëse kjo çështje ishte evidentuar edhe në auditimet e viteve paraprake. Mosfunksionimi i kësaj njësie kishte vazhduar për shkak të mungesës së bashkëpunimit dhe mbështetjes nga menaxhmenti, duke ndikuar që funksioni i auditimit të brendshëm të mbetet joefektiv për disa vite me radhë.

Gjithashtu, Komuna nuk kishte themeluar Komitetin e Auditimit, i cili sipas kërkesave ligjore ka rol në mbështetjen dhe mbikëqyrjen e funksionit të auditimit të brendshëm dhe në forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve efektive menaxheriale, si dhe mungesës së bashkëpunimit institucional ndërmjet menaxhmentit dhe NjAB.

Ndikimi

Mosfunksionimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe mungesa e Komitetit të Auditimit kanë ndikuar në dobësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, duke rritur rrezikun që mangësitë dhe parregullsitë në proceset financiare dhe operative të mos identifikohen dhe trajtohen me kohë.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të ndërmarrë veprime konkrete për funksionalizimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe themelimin e Komitetit të Auditimit, duke siguruar mbështetje, bashkëpunim dhe kushte të nevojshme për ushtrimin efektiv të funksionit të auditimit të brendshëm, në përputhje me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjate auditimit u identifikuan disa çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre. Këto ishin si më poshtë:

Çështjet materiale të cilat ne i kemi identifikuar dhe janë përmirësuar gjatë kohës së auditimit

Çështja 1 **Mos pajtueshmëritë lidhur me deklaratimet në Pasqyrat Vjetore Financiare**

Gjetja

Në Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025 të Komunës së Fushë Kosovës kemi identifikuar mos-pajtueshmëri në deklarime si në vijim:

1. Neni 13, Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, vlera e granteve të përcaktuara të donatorëve e tek burimet e fondeve, si dhe vlera e shpenzimeve të subvencioneve dhe transfereve për vitin 2025, tek shfrytëzimi i fondeve, nuk ishin prezantuar saktë;
2. Neni 14, Raporti i ekzekutimit të buxhetit, tek dalja e parasë së gatshme, vlera e buxhetit final dhe vlera e realizimit të kategorisë së Subvencioneve dhe Transfereve, nuk ishte prezantuar saktë;
3. Shpalosjet-Vlerat e të hyrave të pranuar dhe atyre të shpenzuara të prezantuara tek neni 21, si dhe vlerat e pranimeve dhe shpenzimeve nga grantet të prezantuara tek neni 24, nuk ishin të sakta.

Veprimi i kërkuar

Komunës i është kërkuar të bëjë korrigjimet e nevojshme në Pasqyrat Vjetore Financiare me qëllim të sigurimit të paraqitjes së saktë dhe të plotë të informacionit financiar.

Rezultati

Komuna ka ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe ka korrigjuar mos-pajtueshmëritë e identifikuar, në përputhje me kërkesat ligjore. Megjithatë, komuna duhet të ketë në vëmendje forcimin e kontrolleve të brendshme në procesin e përgatitjes dhe rishikimit të raporteve financiare, me qëllim të parandalimit të përsëritjes së çështjeve të ngjashme në të ardhmen. Në rast të përsëritjes, çështja do të trajtohet si gjetje me rekomandim përkatës.

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁷	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	16,747,839	22,620,338	20,472,311	20,814,005	16,628,215
Grante Qeveritare - Buxheti	13,288,164	13,890,696	13,704,576	13,655,242	12,344,937
Të bartura nga viti i kaluar	0	4,372,572	3,580,060	4,465,983	2,849,798
Të hyrat vetanake	3,459,675	4,034,684	2,875,093	2,649,268	1,380,788
Donacionet vendore	0	8,804	0	43,511	48,692
Donacionet e jashtme	0	313,582	312,582	0	4,000

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 5,872,499€. Kjo rritje është rezultat i vendimeve të qeverisë në vlerë 602,532€, të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 4,372,572€, rritjes së të hyrave vetanake në vlerë 575,009 si dhe donacioneve në vlerë 322,386€.

Komuna e Fushë Kosovës ka shpenzuar 90% të buxhetit përfundimtar ose 20,472,311€, me një zvogëlim prej 2% në krahasim me vitin 2024. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	16,747,839	22,620,338	20,472,311	20,814,005	16,628,215
Pagat dhe mëditjet	8,620,214	9,242,746	9,242,047	9,222,405	7,978,820
Mallrat dhe shërbimet	2,125,968	2,489,172	2,443,289	2,284,222	2,711,211
Komunalitë	350,000	350,000	349,766	349,905	258,388
Subvencionet dhe transferet	1,298,675	1,739,697	1,730,843	1,374,897	1,481,331
Investimet Kapitale	4,352,982	8,798,723	6,706,366	7,582,575	4,198,465

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë ekonomike të buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 622,532€. Kjo rritje ishte rezultat i vendimit të Qeverisë në vlerë prej 602,532€ si dhe bartjes së të hyrave vetanake në vlerë prej 20,000€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 100%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 363,204€. Ky ndryshim ishte rezultat i bartjes së të hyrave nga viti paraprak në vlerë prej 361,230€ si dhe donacioneve në vlerë prej 1,974€. Realizimi i buxhetit final ishte 98%.
- Buxheti final për shpenzime komunale nuk kishte pësuar ndryshime në raport me buxhetin fillestar, ndërsa realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 100%.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte rritur për 441,022€ si rezultat i bartjes së të hyrave vetanake nga viti paraprak në vlerë prej 121,610€ si dhe donacioneve/pagesave direkte në vlerë prej 319,412€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 99%.
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 4,445,741€. Ky ndryshim ishte rezultat i bartjes së të hyrave nga viti paraprak në vlerë prej 4,444,741€ si dhe prej donacioneve në vlerë prej 1,000€. Shkalla e realizimit të buxhetit në këtë kategori ishte 76%. Në nivelin jo të kënaqshëm të realizimit të buxhetit kanë zgjatja e procedurave të prokurimit për projekte të reja, si pasojë e ankesave të operatorëve në OSHP, si dhe fakti që pjesa më e madhe e buxhetit për investime kapitale ishte e orientuar në projekte në vazhdim, të të kontraktuara në vitet paraprake.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e realizuara nga Komuna gjatë vitit 2025 ishin 4,814,794€. Këto të hyra kryesisht përbëhen të hyrat nga lejet ndërtimore, tatimi në pronë, taksat për ndërrim të destinimit të tokës, participimet, si dhe taksa tjera komunale.

Për vitin 2025, Komuna kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 3,459,675€, me një rritje në realizim për 1,355,119€. Në krahasim me vitin e kaluar niveli i inkasimit të të hyrave, kishte shënuar rritje prej 788,673€, kryesisht si rezultat i rritjes së të hyrave jo tatimore.

Po ashtu, gjatë vitit 2025 Komuna ka përfituar 1,183,933€ nga gjobat në trafik dhe 105,305€ nga gjobat e gjykatave. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme pasi planifikimi dhe inkasimi i tyre realizohet nga institucionet përkatëse, ndërsa Komunës i alokohen në baza tremujore për realizim të pagesave.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	3,459,675	3,459,675	4,814,794	4,026,121	3,354,157
Të hyrat tatimore	1,273,081	1,273,081	1,694,689	1,516,002	1,489,471
Të hyrat jo tatimore	2,186,594	2,186,594	3,119,569	2,510,060	1,864,687
Të hyrat tjera	0	0	536	59	

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 për Komunën e Fushë Kosovës ka rezultuar në 15 rekomandime kryesore. Komuna nuk kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, tetë (8) rekomandime janë zbatuar, pesë (5) nuk janë zbatuar ende, një (1) rekomandim ishte në proces, si dhe një (1) rekomandim nuk është i aplikueshëm më, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë që përgatitja dhe prezantimi i buxhetit të kategorive ekonomike në PVF të jetë në pajtim me kërkesat e Rregullores MF-Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga OB-të. Gjithashtu, të sigurohet që lista e detyrimeve kontigjente azhurnohet me kohë, dhe se prezantimi i tyre në pasqyrat financiare të jetë i plotë dhe i drejtë.	Komuna ka përmirësuar përgatitjen dhe prezantimin e buxhetit sipas kategorive ekonomike në PVF, duke e harmonizuar atë me kërkesat e rregullores në fuqi. Megjithatë, prezantimi i detyrimeve kontigjente në PVF vazhdon të mos jetë i plotë dhe i drejtë.	Pjesërisht i zbatuar

2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të shtojë masat e kontrollit në menaxhimin e kontratave dhe të siguroj se menaxherët e kontratave dhe mbikëqyrësit e tyre të mos aprovojnë situacione të punëve të pa përfunduara. Më tutje, punët dhe furnizimet të cilat janë paguar dhe nuk janë përfunduar, të finalizohen në pajtim me kontratën.	Gjatë vitit 2025 nuk janë evidentuar raste të tilla.	I zbatuar
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se vlerat e nënshkruara të kontratave publike për projektet kapitale nuk tejkalojnë shumat e aprovuara me ligjin mbi ndarjet buxhetore.	Gjatë vitit 2025 nuk janë evidentuar raste të tilla.	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që në rastet kur kontratat publike nuk arrijnë të përfundohen brenda periudhës së kontraktuar, siguria e ekzekutimit të kontratës vazhdohet edhe për një periudhë shtesë në të cilën parashihet finalizimi i kontratës. Pagesat përmbyllëse të kontratave të mos realizohen pa u siguruar paraprakisht garancioni bankar i kualitetit të punimeve.	Gjatë vitit 2025 nuk janë evidentuar raste të tilla.	I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj që për projektet e financimit të OJQ-ve të bëhet monitorimi dhe të sigurohen raportet kthyesë nga përfituesit e subvencioneve me qëllimin që fondet publike të shfrytëzohen në mënyrë efektive. Përfituesit që nuk kanë raportuar për mjetet e shfrytëzuara të përjashtohen nga e drejta e përfitimit të subvencioneve në të ardhmen.	Gjatë vitit 2025 nuk janë evidentuar raste të tilla.	I zbatuar
6.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë rritjen e aktiviteteve për verifikim të pronave të paluajtshme, në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.	Nuk janë ndërmarrë veprime, pasi që edhe në vitin 2025 është reflektuar çështja e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë që njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore koordinohet me drejtoritë përkatëse dhe përfshihet në procesin e rekrutimit të nëpunësve të shërbimit publik.	Nuk është rregulluar as gjatë vitit 2025.	Nuk ka filluar zbatimin
8.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj që subvencionimi i OJQ-ve dhe përfituesve individual, të zhvillohet në pajtim me kriteret e parapara ligjore për subvencionim si dhe kriteret e përcaktuara me thirrjen publike.	Gjatë vitit 2025 nuk janë evidentuar raste të tilla.	I zbatuar

9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet e tilla përfshihen në planifikimet buxhetore, duke mundësuar regjistrimin dhe pagesën nga buxheti i kategorive dhe kodeve ekonomike përkatëse dhe në përputhje me planin kontabël të thesarit, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PVF.	Edhe gjatë vitit 2025 kemi hasur keqklasifikme të shpenzimeve qoftë për shkak të pagesave të ekzekutuara nga Thesari sipas vendimeve gjyqësore apo edhe për shkak të keq buxhetimit nga ana e vet komunës.	Nuk ka filluar zbatimin
10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se para inicimit të projekteve për punë, të përmbushen kushtet e realizimit projektit si në aspektin teknik ashtu edhe në aspektin financiar, përmes hartimit të mirëfilltë të projekteve dhe sigurimit të mjaftueshëm të buxhetit në mënyrë që punët të realizohen sipas planit. Gjithashtu, të sigurohet se menaxherët e kontratave dhe mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë të aplikojnë vlerësimin e kontraktuesve përmes platformës elektronike e-Prokurimi.	Gjatë vitit 2025 nuk janë evidentuar raste të tilla.	I zbatuar
11.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se vlerësimi i tenderëve nga komisionet e vlerësimit bëhet në pajtim me kërkesat e përcaktuara me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Ofertuesit që nuk përmbushin kriteret e përcaktuara të mos shpërblehen me kontratë.	Gjatë vitit 2025 nuk janë evidentuar raste të tilla.	I zbatuar
12.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur politika dhe procedura me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e llogarive të arkëtueshme dhe se janë shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet ndaj komunës.	Edhe në vitin 2025 nuk janë ndërmarrë veprime të mjaftueshme për zbatimin e rekomandimit dhe përmirësimin e inkasimit të llogarive të arkëtueshme.	Nuk ka filluar zbatimin

13.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj që kontratat e qirasë të përgatiten dhe nënshkruhen me kohë nga palët kontraktuese me qëllim sigurimin e zbatimit të plotë të kushteve kontraktuale.	Rekomandimi konsiderohet i paaplikueshëm, pasi gjendja ka ndryshuar, sepse është konstatuar se për pronat përkatëse nuk ekziston bazë e vlefshme juridike pronësore për lidhjen e kontratave të qirasë. Kjo situatë është trajtuar si gjetje e re në çështjen: "Mosinkasim i qirave për shkak të paqartësisë së statusit juridik të pronave".	Nuk është i aplikueshëm më
14.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e obligimeve dhe menaxhimin e tyre, duke siguruar fonde të mjaftueshme si dhe pagesën me kohë të faturave, në mënyrë që të shmangen kostot shtesë financiare për shkak të procedurave gjyqësore.	Gjatë vitit 2025 nuk janë evidentuar raste të tilla.	I zbatuar
15.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë një frymë efektive komunikimi dhe bashkëpunimi me NjAB-në, duke ofruar kushte dhe mbështetje për punën e saj, ashtu që të arrihet dakordimi rreth planifikimit dhe kryerjes së auditimeve në përputhje me kërkesat ligjore. Gjithashtu, duhet të formohet Komiteti i Auditimit, organ i cili ka rol aktiv në mbështetjen e NjAB-së dhe menaxhmentit për të siguruar sistem efikas të kontrollit të brendshëm të financave publike.	Gjendja mbetet e njëjtë sikurse në vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit




Ylber Sadiku, Udhëheqës i ekipit







Ardiana Selimaj, Anëtare e ekipit



Shefkije Beka, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

	<p>REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA</p> <p>KOMUNA E FUSHË - KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/ MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE</p>	
<h3>LETËR E KONFIRMIMIT</h3>		
<p>Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve</p>		
<p>Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit</p>		
<p>Të nderuar,</p>		
<p>Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:</p>		
<ul style="list-style-type: none">• kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Fushë Kosovës, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");• pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;• brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.		
Valon Prebreza		
<p>Kryetar i Komunës së Fushë Kosovës</p>		
<p>Fushë Kosovë, 09.06.2026</p>		

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁸ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁹, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Dyfishimi i pronave në 18 raste: Pronë komunale zona kadastrale Vragoli ngastra me nr. 216-2, tokë - 2,919€; Pronë shoqërore e Kuvendit Komunal Fushë Kosovë ngastra nr. 692-1, Fushë Kosovë - 728,700€; Pronë shoqërore e Kuvendit Komunal Fushë Kosovë ngastra me nr. 1209-0, Fushë Kosovë - 589,280€; Pronë komunale varrezat ortodokse në Fushë Kosovë ngastra nr. 191-0, Fushë Kosovë - 577,620€; Pronë shoqërore e Kuvendit Komunal Fushë Kosovë ngastra me nr. 1194-0, Fushë Kosovë - 478,440€; Pronë shoqërore e Kuvendit Komunal Fushë Kosovë ngastra nr. 1203-1, Fushë Kosovë - 309,820€; Pronë shoqërore e Kuvendit Komunal Fushë Kosovë ngastra nr. 696-0, Fushë Kosovë - 177,900€; Pronë shoqërore e Kuvendit Komunal Fushë Kosovë me nr. 2137-0, Fushë Kosovë - 142,300€; Pronë shoqërore e Kuvendit Komunal Fushë Kosovë ngastra nr. 1354-0, Fushë Kosovë - 84,200€; Pronë komunale zona kadastrale Fushë Kosovë ngastra me nr. 1354-0, tokë - 84,200€; Pronë shoqërore e Kuvendit Komunal Fushë Kosovë ngastra nr. 589-1, Fushë Kosovë - 69,630€; Pronë shoqërore e Kuvendit Komunal Fushë Kosovë me nr. 1199-0, Fushë Kosovë - 31,560€; Pronë shoqërore e Kuvendit Komunal Fushë Kosovë ngastra nr. 1250-0, Fushë Kosovë - 26,400€; Pronë shoqërore e Kuvendit Komunal Fushë Kosovë ngastra nr. 417-10, Fushë Kosovë - 16,530€; Pronë shoqërore e Kuvendit Komunal Fushë Kosovë ngastra nr. 404-15, Fushë Kosovë - 8,210€; Pronë komunale zona kadastrale Vragoli ngastra me nr. 215-3, tokë - 7,833€; Pasuri komunale zona kadastrale Vragoli ngastra nr. 210-5, tokë - 1,230€; Pronë komunale zona kadastrale Fushë Kosovë ngastra me nr. 1194-0, tokë - 427,140€ (pagesa e fundit është regjistruar si 478,440€ ndërsa duhet të jetë 51,300€ - diferenca është mbivlerësim); Pronat pa fleta posdeuese në gjashtë (6) raste me këta numra të ngastrave: 428-3, 589-50, 589-50, 213-2, 332-0 si dhe 113-0. Tre (3) pagesa të investimeve kapitale që nuk ishin regjistruar me këta numra të kuponave të shpenzimeve: 2025-446753 në vlerë 106,667.14€; 2025-552065 në vlerë 50,039.96€ si dhe 2025-323388 në vlerë 50,000€; Rastet e mos aplikimit të zhvleresimit për këta numra identifikues: 2008000000001860 ka vlerën 4420,00€, 20060000000011274 ka vlerën 4049,47€, 200600000011282 ka vlerën 3565,32€, 20070000000000316 ka vlerën 3565,22€, 2009000000007282 ka vlerën 1500,00€, 2009000000007286 ka vlerën 1500,00€, 20060000000000769 ka vlerën 1080,00€, 20060000000000771 ka vlerën 1080,00€, 20060000000000772 ka vlerën 1080,00€, 20060000000000774 ka vlerën 1080,00€, dhe 20060000000000775 ka vlerën 1080,00€; Tre (3) raste e gabimeve në regjistrimin e pasurive: pasuria me nr. të artikullit 79253, pasuria me numër të artikullit 141503 si dhe pasuria me numër të ngastrës 767-12.
- ⁶ 1. Lënda I. EK.nr.319/17 për kompensim dëmi në vlerë prej 12,390€, dhe 2. Lënda C.nr.1476/16 për kompensim të pagave shtesë në vlerë prej 59,123€
- ⁷ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁸ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.